



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. 633/1 Prot.

Datë 05.12.2022

VENDIM

Nr. 929, Datë 05.12.2022

“Për mbylljen e procedurës së monitorimit të zbatimit të vendimit nr. 706, datë 10.09.2020 “Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL-të publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL private”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së monitorimit të zbatimit të vendimit nr. 706, datë 10.09.2020 “Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL-të publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL private”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, dhe neni 70, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 706, datë 10.09.2020 në Sektorin e Arsimit të Lartë,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 706, datë 10.09.2020 “Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL-të publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL private”, pikat I, II, III, IV, ka vendosur:

I. T'i rekomandojë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë:

1. Të kryejë një studim të plotë tregu në mënyrë që të përcaktohen kërkesat për studentë/specialistë, i cili duhet të publikohet **para fillimit të çdo viti akademik** dhe duhet të sigurojë:
 - a. Orientimin e IAL-ve për hapjen e programeve të reja të studimit;
 - b. Balancimin e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës;
 - c. Reduktimin e inflacionit të profesionistëve në degë të caktuara;
 - d. Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, duke e drejtuar kërkesën e tyre drejt një oferte, e cila do të garantojë punësimin në një kohë të shkurtër pas diplomimit.
2. Për sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, MASR të hartojë dhe propozojë kuadrin e nevojshëm ligjor për burimet e financimit të IAL-ve private me qëllim që:
 - i) Të ardhurat e përfituara nga këto IAL private nga:
 - a. pagesat e studenteve për arsimim,
 - b. të ardhura për shërbime të kryera,
 - c. të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palë të tjera,
 - d. fonde publike
 - e. donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi,
 - f. veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik të ndahet ndërmjet personelit akademik dhe IAL-së private, sipas rregullores së miratuar nga çdo IAL private.
 - ii) Çdo IAL private të rregullojë me aktet e tyre të brendshme mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e mësipërme.
 - iii) **Afati i përmbushjes së këtij rekomandimi nga MASR është shtator 2021.**
3. Të kërkojë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, për çdo projekt - akt normativ që në mënyrë të veçantë ka të bëjë me:
 - a. kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin;
 - b. vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejta të veçanta në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara;
 - c. imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

II. T'i rekomandojë IAL-ve publike dhe private:

1. Të llogarisin koston për student për secilin program studimi dhe të bëjnë publike tarifën e studimit, për çdo vit akademik.
2. Të bëjnë transparente mënyrën e përdorimit të fondeve duke e publikuar në faqet e tyre zyrtare.
3. Të bëjnë transparent fondin e kërkimit shkencor, kriteret dhe procedurat që njësitë kryesore, njësitë bazë dhe kërkuesit shkencorë si individë duhet të ndjekin për të përfutuar mbështetje financiare për kërkimin shkencor.

4. Të mundësojë ofrimin e informacionit për cilësinë e IAL-së, përpara fillimit të çdo viti akademik në mënyrë që të lehtësohen mundësitë e zgjedhjes së konsumatorëve (studentëve), bazuar në:
 - a) Performancën akademike të studentëve të diplomuar, si dhe nivelin e punësimit të tyre në tregun përkatës të punës;
 - b) Vlerësimin/Reputacionin e IAL në bazë të të dhënave objektive - ekzistenca e qendrave të kërkimit, bibliotekave dhe laboratorëve;
 - c) Lidhjet me universitete ose qendra të njohura kombëtare ose ndërkombëtare;
 - d) Shërbimet e përgjithshme - kampuset;
 - e) Çmimet si një mekanizëm për të balancuar ofertën dhe kërkesën.
5. IAL-të, duhet të informojnë Autoritetin e Konkurrencës, për zbatimin e pikës II të këtij vendimi brenda **muajit mars të vitit 2021**.

III. Detyrimin e IAL-ve private që:

1. Të ndajnë llogarinë ekonomike të tyre me NIPT të veçantë nga llogaria ekonomike e shoqërisë tregtare (SHPK/SHA) ose Fondacionit që e ka krijuar dhe e financon.
2. Zbatimi i detyrimit të pikës III.1 të këtij Vendimi, duhet të realizohet brenda **muajit mars të vitit 2021**.
3. IAL-të private, duhet të informojnë Autoritetin e Konkurrencës, për zbatimin e këtij detyrimi brenda afatit të përcaktuar në pikën III.2.

IV. T'i rekomandojë INSTAT:

1. Të mbledhë të dhëna për arsimin e lartë dhe të mundësojë ofrimin e informacionit krahasues për cilësinë e IAL-ve për çdo vit akademik, në mënyrë që të lehtësojë mundësitë e zgjedhjes së studentëve, për:
 - a. nivelin e punësimit të të diplomuarve sipas fushave; dhe
 - b. profileve të tyre në tregun vendas përkatës të punës.

V. Autoriteti i Konkurrencës, do i drejtohet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në rast të mos përmbushjes së pikës II dhe III të këtij vendimi nga IAL-të, të cilat cenojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, duke kërkuar përmbushjen e tyre.

VI. Mbylljen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë.

VII. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi nga MASR, IAL-të publike dhe private dhe INSTAT për një **periudhë 2 vjeçare**.

2. Në zbatim të vendimit të mësipërm, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka filluar monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe detyrimeve të dhëna me VKK nr. 706/2020 në Sektorin e Arsimit të Lartë.
3. Me qëllim realizimin e procedurave të monitorimit në zbatim të pikave I, II, III dhe IV të VKK nr. 706/2020, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", është kërkuar informacion, nga Ministria e Arsimit

dhe Sportit (ish Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), INSTAT, si dhe nga universitetet publike dhe private, në përgjigje të të cilave, është depozituar informacioni përkatës.

4. Nga administrimi dhe vlerësimi i informacionit të depozituar në kuadër të zbatimit të VKK nr. 706/2020, konstatohet si më poshtë vijon:

a. Mbi rekomandimet drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

5. Me anë të shkresës së saj nr. 5068/1 prot., datë 05.11.2020 (protokolluar me Tonën me shkresën nr. 259/6 prot., datë 06.11.2020) “Mbi vendimin nr. 706, datë 10.09.2020 të Komisionit të Konkurrencës” MAS është shprehur mbi rekomandimet e lëna nga Komisioni i Konkurrencës në pikën I të VKK nr. 706/2020.

6. Lidhur me rekomandimin sipas pikës I.1 të vendimit nr. 706/2020 të Komisionit të Konkurrencës për kryerjen e një studimi të plotë të tregut, në mënyrë që të përcaktohen kërkesat për student/specialist, i cili duhet të publikohet para fillimit të çdo viti akademik MASR shprehet se hapja e programeve të studimit, miratohet nga ministri përgjegjës për arsimin, në bazë të kërkesës të institucionit të arsimit të lartë, bazuar në vlerësimin e nevojave për aftësi në tregun e punës dhe në përputhje me dispozitat e ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Po kështu, udhëzimi nr.1, datë 14.01.2020 i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë , degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, parashikon që brenda datës 31 dhjetor për vitin akademik pasardhës, IAL-të të cilat aplikojnë për hapje programi studimi ngarkojnë në platformën e-Albania aplikimin, sipas formularit përkatës. Ky formular, përcakton që IAL, ndër të tjera, duhet të realizojë një analizë të detajuar të tregut të punës se si programi i përgjigjet nevojave të këtij tregu, duke përfshirë kërkesën aktuale dhe atë të parashikuar të tregut të punës për të diplomuarit e programit të studimit.

Analiza e tregut të punës duhet të përmbushë tre objektiva:

- Të identifikojë se si programi i propozuar rrit aftësitë/mundësitë/potencialin e studentëve për të përfutur aftësi/njohuri që përputhen me kërkesat e tregut të punës me qëllim punësimin e tyre.
- Të identifikojë se si programi i propozuar përmbush kërkesat e punëdhënësve për forcën e punës për një periudhë afatmesme.
- Të identifikojë se si programi i propozuar përshtatet me, ose përmbush, politikat kombëtare të punësimin dhe zhvillimit.

7. Më tej MAS sqaron se IAL-ja, analizën e tregut duhet ta shoqërojë me të dhëna konkrete, referuar në burime zyrtare si INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, organizma ndërkombëtar, etj.

Në zbatim të udhëzimit të sipërcituar, aplikimi i IAL-së i kalon për shqyrtim ekspertëve të licencuar. Në rast se vlerësimi i ekspertëve është pozitiv, ministri përgjegjës për arsimin miraton programin e studimit.”

8. Sa më sipër, MAS shprehet se referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, IAL-të kanë detyrimin që të kryejnë studimin e tregut të punës në çdo aplikim për hapje programi. MAS vlerëson, përmes ekspertëve, përmbushjen e objektivave të studimit të tregut nga ana e IAL-së.
9. Lidhur me rekomandimin sipas pikës I.2 të vendimit nr. 706/2020 të Komisionit të Konkurrencës për hartimin dhe propozimin e kuadrit të nevojshëm ligjor për burimet e financimit të IAL-ve private, MAS shprehet se Institucionet e Arsimit të Lartë funksionojnë sipas parimit të autonomisë financiare. Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, është hartuar, duke patur si qëllim, ndër të tjera, që sistemi i arsimit të lartë, të bazohet në parimin e konkurrencës së lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve. Për këtë, ligji i sipërcituar, përcakton se fondet nga Buxheti i Shtetit, në IAL-të publike shpërndahen në formë granti, për grantin e politikave të zhvillimit dhe atë të mësimdhënies. Aktet nënligjore, të dala në zbatim të këtij ligji, përcaktojnë modelin e financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe skemën e financimit, për institucionet publike të arsimit të lartë.
10. Bazuar në nenin 113, të ligjit nr. 80/2015, institucionet e arsimit të lartë, kanë të drejtë të përfitojnë nga granti i punës kërkimore-shkencore, i cili përfshin fondet për kërkimin shkencor. Pjesë e këtij granti janë edhe fondet për studimet e doktoraturës, të cilat u jepen institucioneve të arsimit të lartë mbi bazën e aplikimit. Nga ky fond përjashtohet financimi i ngarkesës së pedagogëve për udhëheqjen e doktoraturës. Ky grant është i hapur për të gjitha institucionet e arsimit të lartë të akredituara që zhvillojnë kërkim shkencor, duke përfshirë si IAL-të publike dhe ato jopublike. Në ndryshim nga IAL-të publike, të cilat janë persona juridikë publikë që vetëfinancohen, financohen nga Buxheti i Shtetit ose nga burime të tjera të ligjshme, institucionet jopublike të arsimit të lartë janë persona juridikë privatë. Veprimtaria që ato zhvillojnë mund të jetë fitimprurëse ose jofitimprurëse. IAL-të private fitimprurëse janë të organizuara në formën e shoqërive tregtare dhe funksionojnë në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ndërsa IAL-të jofitimprurëse funksionojnë në përputhje me ligjin nr. 8788/2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar. Si të tilla, bazuar në legjislacionin në fuqi, IAL-të kanë detyrim të depozitojnë pranë organeve kompetente pasqyrat financiare, bilancet vjetore, tatimet mbi të ardhurat personale apo kontributet e sigurimeve shoqërore të personelit akademik. Sa më sipër MAS sqaron se vlerëson se përcaktimi i burimeve të financimit të IAL-ve private është jashtë fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.”
11. Lidhur me rekomandimin sipas pikës I.3 të vendimit nr. 706/2020 të Komisionit të Konkurrencës, Ministria e Arsimit dhe Sportit është shprehur se do të marrë mendimin e Autoritetit të Konkurrencës lidhur me projekt aktet-normative, që kanë të bëjnë me:
- a. kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin;
 - b. vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejta të veçanta në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara;

c. imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

12. Në shkresën e saj nr. 5068/1 prot., datë 05.11.2020 (protokolluar me Tonën me shkresën nr. 259/6 prot., datë 06.11.2020), MAS shprehet se lidhur me analizën e konkurrencës në tregun e ofrimit të shërbimit të arsimit të lartë, do të vlerësonin rishikimin e rekomandimeve I.1 dhe I.2 të vendimit nr. 706, datë 10.09.2020 të Komisionit të Konkurrencës.

b. Mbi rekomandimet drejtuar INSTAT

13. Lidhur me rekomandimin në pikën IV të VKK nr. 706/2020, me anë të shkresës nr. 1383/2 prot., datë 15.02.2021 “Kthim përgjigje” (protokolluar me tonën me nr. 259/13 prot., datë 16.02.2021), INSTAT shprehet se në përmbushje të Programit 5 vjeçar të Statistikave Zyrtare, i miratuar edhe në nivel vjetor nga Kuvendi i Shqipërisë, që nga viti 2012 INSTAT prodhon dhe publikon rregullisht statistika për arsimin e lartë dhe konkretisht statistika¹ të detajuara mbi të regjistruarit dhe të diplomuarit sipas programeve të studimit, fakulteteve dhe fushave të studimit për çdo vit akademik.

14. Për sa i përket rekomandimit tonë lidhur me mbledhjen e të dhënave për arsimin e lartë dhe ofrimit të informacionit krahasues për cilësinë e IAL-ve për çdo vit akademik mbi nivelin e punësimit të të diplomuarve sipas fushave, si dhe profileve të tyre në tregun vendas përkatës të punës, INSTAT shprehet se nuk ka një mundësi matjeje të drejtpërdrejtë të këtyre treguesve, por ka analizuar mundësinë e vlerësimit të tyre nëpërmjet Anketës së Forcave të Punës, e cila është një vrojtim me zgjedhje me qëllim matjen e nivelit dhe strukturës së punësimit ndër vite, pra të nivelit të punësimit dhe papunësisë në vend. Treguesit e vlerësuar të bazuar në të dhënat e kësaj ankete gëzojnë nivele të caktuara të besueshmërisë. Në përgjithësi, sa më i lartë dizagregimi i treguesve, aq më shumë ulet niveli i saktësisë statistikore dhe, në këto raste treguesit e prodhuar duhet të trajtohen me rezervë. Si rrjedhim, të dhënat që rekomandohet të ofrohen, nuk do të mund të jenë statistika zyrtare, por mund t'u jepen palëve të treta kundrejt kërkesës, në përputhje me përmbushjen e niveleve të caktuara të saktësisë dhe duke i shoqëruar me shpjegimet e kufizimeve të tyre.

15. Sa më sipër, me anë të shkresës nr. 259/14 prot., datë 24.02.2021 Autoriteti i Konkurrencës informon INSTAT se informacioni mbi nivelin e punësimit të të diplomuarve sipas fushave dhe profileve të tyre në tregun e punës, do t'u shërbejë të gjithë pjesëmarrësve të tregut të arsimit të lartë:

- MASR, si një mekanizëm ndihmës në procesin e hartimit të politikave për arsimin e lartë;
- IAL-ve publike dhe private në procesin e planifikimit të kuotave të studimit për çdo program studimi;
- Studentëve për të lehtësuar mundësinë e zgjedhjes së fushës së studimit.

Në mënyrë që ky informacion të sa më i vlefshëm duhet që frekuenca e publikimit të jetë vjetore, duke patur për bazë vitin akademik (Tetor – Shtator i vitit pasardhës).

¹ Këto statistika janë të disponueshme në faqen zyrtare të INSTAT:

http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_ED/?rxid=03fde475-61d6-4c8f-956b-f6764a9286d5

c. Mbi rekomandimet drejtuar IAL-ve publike dhe private, dhe detyrimet drejtuar IAL-ve private

16. Në kuadër të monitorimit të pikave II dhe III të VKK nr. 706/2020 lidhur me rekomandimet drejtuar IAL-ve publike dhe private dhe detyrimin drejtuar IAL-ve private, me anë të shkresave nr. 259/15 prot., datë 25.02.2021 dhe nr. 259/16 prot., datë 25.02.2021 “Kërkesë për informacion”, IAL-ve private u është kërkuar informacion lidhur me zbatimin e pikave II dhe III të vendimit nr. 706/2020 të Komisionit të Konkurrencës, ndërsa IAL-ve publike lidhur me zbatimin e pikës II të VKK nr. 706/2020.
17. Në vijim të procedurës së monitorimit, IAL-ve të cilat nuk kanë sjellë informacion deri më 31 mars 2021, u është rikërkuar informacion me anë të shkresave nr. 165/7 prot., datë 12.05.2021 dhe nr. 165/11 prot., datë 12.05.2021.
18. Gjithashtu, me anë të shkresës nr. 165/22 prot., datë 26.05.2021 është rikërkuar nga IAL private informacion shtesë/dokumentacioni përkatës që vërteton zbatimin e pikave II.2 dhe II.3 të VKK nr. 706/2020 lidhur me bërjen transparent të mënyrës së përdorimit të fondeve dhe fondit të kërkimit shkencor, kritereve dhe procedurave që njësitë kryesore, njësitë bazë dhe kërkuesit shkencorë si individë duhet të ndjekin për të përfituar mbështetje financiare për kërkimin shkencor duke i publikuar në faqet e tyre zyrtare.
19. Gjithashtu, nëpërmjet shkresave nr. 259/39 prot., datë 19.3.2021 dhe nr. 259/40 prot., datë 19.3.2021 “Kërkesë për informacion”, drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është kërkuar informacion në lidhje me zbatimin e pikës III të VKK nr. 706/2020 për IAL private, të cilat kanë realizuar ndarjen e llogarive ekonomike me NIPT të veçantë nga llogaria ekonomike e shoqërisë tregtare (SHPK/SHA) ose Fondacionit që e ka krijuar dhe e financon, duke përditësuar apo ndryshuar NIPT (kanë hapur NIPT sekondar apo krijuar NIPT të veçantë) gjatë periudhës Shtator 2020 - Mars 2021.
20. QKB në shkresën e saj nr. 165/3 prot., datë 01.04.2021 “Kthim përgjigje”, në lidhje me listën e 26 IAL-ve private, shprehet se nga verifikimi i kryer në regjistrin tregtar subjektet ALDENT, Universiteti Albanian University dhe Kolegji Universitar Instituti Kanadez i Teknologjisë (IKT), kanë aplikuar për hapjen e adresës dytësore; subjektet Universiteti Epitech Albania, Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë, Akademia Marubi, Shkolla Nehemia, Universiteti Mesdhetar, dhe KU Bedër nuk figurojnë të jenë regjistruar në regjistrin tregtar.
21. Monitorimi i zbatimit të VKK nr.706, datë 10.09.2020 për secilin IAL publik dhe privat është bërë duke u mbështetur në informacionin e depozituar nga IAL-të në përgjigje të shkresave të Autoritetit të Konkurrencës dhe në monitorimin e faqeve të tyre zyrtare të internetit, sipas dy grupimeve për IAL-të private dhe IAL-të publike.

22. Në përfundim të monitorimit rezulton se Institucionet e Arsimit të Lartë publike në zbatim të rekomandimeve të pikës II të VKK nr. 706/2020 kanë depozituar pranë AK-së informacionet përkatëse lidhur me llogaritjen e kostos për student për secilin program studimi, publikimin e tarifave të studimit për çdo vit akademik, bërjen transparente të mënyrës së përdorimit të fondeve, duke e publikuar në faqet e tyre zyrtare dhe bërjen transparent të fondit të kërkimit shkencor, kriteret dhe procedurat, që njësitë kryesore, njësitë bazë dhe kërkuesit shkencorë si individë duhet të ndjekin për të përfutur mbështetje financiare për kërkimin shkencor, si dhe ofrimin e informacionit për cilësinë e IAL-së duke u bazuar në: a) performancën akademike të studentëve të diplomuar, si dhe nivelin e punësimit të tyre në tregun përkatës të punës; b) vlerësimin/reputacionin e IAL në bazë të të dhënave objektive - ekzistenca e qendrave të kërkimit, bibliotekave dhe laboratorëve; c) lidhjet me universitete ose qendra të njohura kombëtare ose ndërkombëtare; d) shërbimet e përgjithshme - kampuset; e) çmimet si një mekanizëm për të balancuar ofertën dhe kërkesën, përpara fillimit të çdo viti akademik, në përmbushje të rekomandimit të dhënë nëpërmjet pikës II të VKK nr. 706/2020.
23. Institucionet e Arsimit të Lartë private në zbatim të rekomandimeve të pikës II të VKK nr. 706/2020 kanë depozituar pranë AK-së informacionet përkatëse lidhur me llogaritjen e kostos për student për secilin program studimi, publikimin e tarifave të studimit për çdo vit akademik, bërjen transparente të mënyrës së përdorimit të fondeve, duke e publikuar në faqet e tyre zyrtare dhe bërjen transparent të fondit të kërkimit shkencor, kriteret dhe procedurat, që njësitë kryesore, njësitë bazë dhe kërkuesit shkencorë si individë duhet të ndjekin për të përfutur mbështetje financiare për kërkimin shkencor dhe ofrimin e informacionit për cilësinë e IAL-së, duke u bazuar në: a) performancën akademike të studentëve të diplomuar, si dhe nivelin e punësimit të tyre në tregun përkatës të punës; b) vlerësimin/reputacionin e IAL në bazë të të dhënave objektive - ekzistenca e qendrave të kërkimit, bibliotekave dhe laboratorëve; c) lidhjet me universitete ose qendra të njohura kombëtare ose ndërkombëtare; d) shërbimet e përgjithshme - kampuset; e) çmimet si një mekanizëm për të balancuar ofertën dhe kërkesën, përpara fillimit të çdo viti akademik, në përmbushje të rekomandimit të dhënë nëpërmjet pikës II të VKK nr. 706/2020.
24. Në zbatim të detyrimit të pikës III të VKK nr. 706/2020, lidhur me ndarjen e llogarisë ekonomike të tyre me NIPT të veçantë nga llogaria ekonomike e shoqërisë tregtare (SHPK/SHA) ose fondacionit që e ka krijuar dhe e financon, disa nga Institucionet e Arsimit të Lartë private kanë hapur adresa dytësore në përmbushje të detyrimit të dhënë nëpërmjet pikës III të VKK nr. 706/2020, ndërsa pjesa më e madhe e IAL-ve shprehen se objekti i vetëm i tyre është krijimi i Universitetit dhe kanë një llogari ekonomike të vetme.
25. Në përfundim të periudhës së monitorimit, në bazë të informacionit të administruar nga IAL-të publike dhe private, si dhe monitorimit të faqeve të tyre zyrtare të internetit, rezulton se kanë përmbushur rekomandimet dhe detyrimin sipas dispozitivit të VKK nr. 706, datë 10.09.2020 “Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL-të publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL private”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të VKK nr. 706, datë 10.09.2020 “Për mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL-të publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL private”.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA




Zv/Kryetar

Rezana KONOMI




Anëtar

Adriana BERBERI



Anëtar

Durim KRAJA



Anëtar

